



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ANALIZË

E TREGUESVE KRYESORË TË PUNËS PËR VITIN 2017 TË PROKURORISË SË RRETHIT GJYQËSOR KRUJE

DREJTUAR :
PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
Znj.Arta Marku

TIRANË

E nderuar Znj. Prokurore e Përgjithshme!

Në mbyllje të vitit 2017 në zbatim të detyrimeve ligjore nëpërmjet këtij materiali Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kruje paraqet arritjet dhe objektivat e realizuar gjatë ushtrimit të ndjekjes penale në fazën e hetimit paraprak dhe në gjykim, kryerjen e detyrimeve të tjera të parashikuara në ligj nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore si dhe analizon treguesit sasiorë dhe cilësorë në përgjithësi dhe në veçanti për secilin prokuror duke përgjithësuar përvojën pozitive, por njëkohësisht duke nënvizuar mangësitë e vërejtura dhe problemet që kanë lindur gjatë këtij viti gjyqësor me synimin e vetëm përmirësimin e vazhdueshëm të këtyre treguesve dhe goditjen në kohë dhe me efikasitet të veprave kriminale në territorin e Rrethit Gjyqësor në të cilin ajo ushtron aktivitetin e saj duke trajtuar me përparësi çështjet më problematike që shqetësojnë komunitetin e këtij rrethi që janë veprat penale kundër jetës e shëndetit, veprat penale kundër pasurisë, veprat penale në fushën e narkotikeve, veprat penale në fushën e veprimtarisë shtetërore të kryera nga nëpunësit shtetërorë, veprat penale kundër rendit e sigurisë publike, në veçanti këtu çështjet që lidhen me prodhimin dhe mbajtjen pa leje të armëve luftarake dhe municionit, kryesisht të lendeve plasuese, veprat penale kundër fëmijëve, martesë dhe familjes, veprat penale kundër mjedisit etj.

Në këtë kuadër, duke zbatuar detyrimin kushtetues si autoriteti i vetëm për ushtrimin e ndjekjes penale, kemi qenë të angazhuar për të kryer një hetim sa më të plotë dhe të gjithanshëm, për të gjitha procedimet e trajtuara gjatë këtij viti, për të ngritur dhe përfaqësuar sa më mirë akuzën në gjykim, për të ekzekutuar në kohë vendimet penale të gjykatave dhe për të mbikqyrur në vazhdimësi vuajtjen e dënimit të të dënuarve, për të bashkërenduar punën me të gjithë aktoret e tjera në përmbushjen e detyrimeve lidhur me mardheniet juridiksionale me autoritetet e huaja etj.

Krahas kësaj, në përputhje me detyrimet e parashikuara shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin procedural penal jemi përpjekur që në veprimtarinë tonë të respektojmë të gjitha kërkesat e një procesi të rregullt ligjor ndaj personave të dyshuar si autorë të veprave penale duke u garantuar të gjitha të drejtat që iu njeh ligji dhe duke ndërhyrë në të gjitha rastet kur të drejtat e tyre janë cënuar nga organe të tjera.

Për veprat penale të rënda me ndjeshmëri të madhe në opinionin publik e shoqëror të përmendura me sipër kemi bërë përpjekje serioze që hetimet t'i përfundojmë shpejt e me cilësi, duke zbatuar një politikë ndëshkimi në përputhje me rëndësinë e faktit dhe efektet për parandalimin e tyre me qëllimin e vetëm për të garantuar një jetë të sigurtë dhe me sa më pak probleme për komunitetin.

Por, pavarësisht kësaj, nga analiza në tërësi konstatohet se ka ende nevojë për të treguar më shumë gadishmëri dhe më shumë profesionalizëm në kryerjen e detyrave tona nga e gjithë trupa e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore për të vlerësuar me seriozitet çdo njoftim apo kallëzim që marrim nga qytetarët, institucionet dhe çdo burim tjetër i ligjshëm në të cilët konstatohen elemente të veprave penale.

Risia e kësaj analize krahasuar me vitet e mëparshme është fakti se gjatë këtij viti filloi implementimi i ligjeve të reja në kuadrin e Reformës në Drejtësi të cilat kanë sjelle shumë ndryshime në aktivitetin procedural të Organit të Prokurorisë. Kështu për herë të parë prokurorët e ceshtjes janë plotësisht të pavarur në vendimarrje dhe është krijuar një raport i ri ndërmjet tyre dhe drejtuesit të Prokurorisë. Po kështu kanë hyrë në fuqi ndryshimet e reja në K.Penal dhe në K.Pr. Penale të cilat i japin një rol më aktiv Gjykatës gjatë fazës së hetimeve paraprake si dhe janë shtuar disa institute të reja si ai i gjykimit me mareveshje dhe urdheri penal të cilat e bëjnë më dinamik procesin penal në tërësi. Për hir të se vertetes duhet pohuar se ende nuk jemi ambientuar plotësisht me këto ndryshime dhe se kjo gjë kërkon më shumë impenjim nga prokurorët për të zbatuar me kujdes ndryshimet ligjore të cilat do të japin një drejtësi më të mirë dhe më të shpejtë për njerezit.

Gjatë këtij viti të cilin po analizojmë kjo Zyrë ka ushtruar ndjekjen penale për **647** procedime nga **688** të vitit 2016 si dhe për **409 (268+ 141)** persona të pandehur dhe nën hetim nga **442 të vitit 2016**. Nga sa shihet ka një rënie të lehtë të numrit të ceshtjeve penale të regjistruara e reflektuar kjo edhe në numrin e personave të proceduar.


Në një këndvështrim të përgjithshëm shihet qartë se veprat penale më të përhapura gjatë këtij viti kanë qenë **krimet kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike** gjithsej **302**

procedime ku numrin me te madh e zene ato te parashikuara nga neni 134 i K.Penal (vjedhje pasurise) **118** procedime, , (veprat penale qe cenojne regjimin juridik te tokes dhe te ndertimeve) **102** procedime, neni 143 i Kodit Penal (mashtrimi) **13** procedime, neni 150-162 (shkaterrimi prones) **44**procedime, **veprat penale kunder rendit dhe sigurise publike** gjithesej **185** procedime nga te cilat **55** procedime per “Kultivim te bimeve narkotike”, parashikuar nga neni 284 i K.Penal, **31** procedime per “Prodhim dhe shitje te narkotikeve” , parashikuar nga neni 283 i K.Penal, **27** procedime per “Shkelje te rregullave te qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290 i K.Penal, **25** procedime per vepren penale “Drejtimi automjeteve ne menyre te parregullt “ parashikuar nga neni 291 i K.Penal, **10** procedime per nenin 278 te K.Penal, **11** procedime per nenin 275 te K.Penal, **8** procedime per nenin 277 te K.Penal dhe 5 procedime per nenin 287 te K.Penal, **krimet kunder jetes dhe shendetit 63** procedime,**veprat penale kunder drejtesise** gjithesej **42** procedime , **krimet kunder veprimtarise shteterore** gjithesej **30** procedime ku numerin me te madh e zene ato te parashikuara nga neni 248 i K.Penal (Shperdorimi i detyres) **20** procedime, **veprat penale kunder mjedisit 17** procedime etj.


Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike përhapja e veprave penale në rrethin e Krujës gjatë vitit 2017 dhe krahasimin e tyre me vitin 2016 për të parë me mirë tendencat për çdo grup vepre penale.

Sipas veprave penale

- Veper penale kunder pasurise dhe ne sferen ekonomike (302 Procedime)
- Veper penale kunder rendit dhe sigurise publike (185 Procedime)
- Krime kunder jetes dhe shendetit (63 Procedime)
- Veper penale kunder drejtesise (42 Procedime)
- Veper penale kunder autoritetit te shtetit (30 Procedime)
- Krime kunder mjedisit (17 Procedime)
- Te tjera (11 Procedime)




Veprat penale krahasuar me vitin 2016 :



Konkretisht, figurat e veprave penale më të përhapura janë si më poshtë:

Sipas Neneve

■ Neni 284 K.Penal (55 Procedime)	■ Neni 283 K.Penal (31 Procedime)
■ Neni 290 K.Penal (27 Procedime)	■ Neni 291 K.Penal (25 Procedime)
■ Neni 278 K.Penal (10 Procedime)	■ Neni 248 K.Penal (20 Procedime)
■ Neni 134 K.Penal (104 Procedime)	■ Neni 130/a K.Penal (25 Procedime)
■ Neni 139 K.Penal (7 Procedime)	■ Neni 151 K.Penal (25 Procedime)
■ Neni 152 K.Penal (9 Procedime)	■ Neni 324/a K.Penal (30 Procedime)
■ Nene te tjera (279 Procedime)	



Hetimet e kryera për këto kategori veprash penale tregojnë se shkaqet e përhapjes së tyre janë të ndryshme, sociale dhe ekonomike, probleme të mosfunksionimit të organeve të qeverisjes vendore dhe organizmave të tjere ligjzbatues, probleme të infrastrukturës dhe

edukimit të pamjaftueshëm në respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor nga drejtuesit e mjeteve, por edhe nga shtetasit, mosfunksionimi i rregullt i strukturave të ndryshme shtetërore që mbikqyrin veprimtari të palejuara dhe në shkelje të ligjit, etj.


Në regjistrat e kësaj prokurorie janë regjistruar për **vitin 2017** gjithsej **647** procedime penale me **409** persona të pandehur dhe nën hetim prej të cilëve **111** kanë qenë të me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Nga viti 2016 janë mbartur gjithsej **131** procedime penale me **77** persona të pandehur nga të cilët **22** të pandehur kanë qenë me masë sigurimi “Arrest në burg”.

NË TOTAL:

Në vitin 2017 duke përfshirë edhe çështjet e mbartura është ushtruar ndjekja penale në hetimin paraprak për **778** procedime penale me **486** persona të pandehur dhe nën hetim, ndër të cilët **133** kanë qenë me masë sigurimi “Arrest në burg”, ndërsa pjesa tjetër janë ndjekur me masa të tjera sigurimi.

Më poshtë paraqitet grafikisht krahasimi mes numrit të çështjeve të përfunduara gjatë vitit 2017 dhe 2016, sipas mënyrës së përfundimit:



Për vitin 2017 është vendosur mosfillimi për **273** materiale kallezues dhe janë në fazë verifikimi edhe **16** materiale të tjera. Për të gjitha këto raste është treguar kujdesi i duhur që vendimi të merret mbasi të jenë kryer verifikimet e nevojshme dhe brenda afatit të përcaktuar

në ligj. Përgjithësisht është respektuar ky afat me përjashtim të disa rasteve kur vonesat kanë ardhur për shkaqe objektive, siç është rasti i vonesave të akteve të ekspertimit kryesisht mjekoligjore etj, por në raste të veçanta edhe për neglizhencë nga oficerët e policisë gjyqësore të ngarkuar për të kryer verifikimet apo edhe nga vetë prokurorët. Mendojmë se politika e ndjekur në rastet e vendimeve të mosfillimit ka shërbyer jo vetëm për të mos harxhuar energji të panevojshme, por edhe për të parandaluar fillimin e ndjekjes penale ndaj personave të cilët në fakt nuk dyshohen të kenë kryer ndonjë vepër penale. Në zbatim të detyrimeve të ligjit procedural penal të gjithë personave të interesuar u janë komunikuar vendimet e mosfillimit duke u dhënë atyre mundësinë për të ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatë.

Nga procedimet penale të mosfilluara janë ankimuar në Gjykatë **22** prej tyre. Gjykata ka lënë në fuqi vendimet e mosfillimit në **11** raste dhe **3** raste janë shfuqizuar.

Gjatë vitit 2017 janë transferuar **19** procedime penale me **37** të pandehur/persona nën hetim. Kryesisht procedimet penale të transferuara janë dërguar në Prokurorinë Pranë Gjykeses së Shkallës së Parë Tiranë, Seksionit për të Mitur, dhe pjesa tjetër në Prokurorinë për Krime të Renda dhe në rrethe për shkak të kompetencës tokësore.

HETIMI PARAPRAK

Për vitin 2017 treguesit e arrestimeve në flagrancë dhe ndalimeve të kryera ndaj shtetasve të dyshuar si autorë të veprave penale të ndryshme paraqiten si me poshtë:

Janë arrestuar në flagrancë nga Policia Gjyqësore **168** persona.

Është nxjerrë urdhër ndalimi nga Prokurori për **2** shtetas.

Për **3** persona të arrestuar në flagrancë apo të ndaluar nga Policia Gjyqësore, Prokurori ka disponuar me urdhër për lirim të menjëhershëm. Në Gjykatë janë dërguar për vleftësimin e arrestit apo të ndalimit **166** persona dhe Gjykata i ka vlerësuar të ligjshme të gjitha kërkesat e prokurorit.

Për këta tregues është kërkuar respektimi me korrektesë i kriterëve të përcaktuar në ligjin procedural penal si dhe garantimi i të drejtave të personave që u është hequr liria duke kushtuar një kujdes të veçantë sidomos për respektimin e garancive që u siguron ligji personave të mitur. Në analizën e treguesve bie në sy fakti se të gjitha kërkesat e paraqitura nga prokurori janë vlerësuar të ligjshme nga Gjykata e Shkallës së Parë. Kjo tregon se konsultimi paraprak i oficerëve të policisë gjyqësore që kryejnë arrestet dhe ndalimet me prokurorët e gatshëm që tashmë është një normë në aktivitetin tonë ka dhënë rezultatet e dëshiruara.

Prokurorët kanë kërkuar caktimin e masës së sigurimit “ arrest në burg” për **120** persona ndërsa nga Gjykata është caktuar kjo masë vetëm për **109** persona. Përveç sa sipër në **12** raste është kërkuar nga prokurori caktimi i kësaj mase për persona të dyshuar si autorë të veprave penale që i janë shmangur hetimit kërkesa të cilat janë pranuar edhe nga Gjykata.

PROCEDIMET PENALE TË PUSHUARA

Janë pushuar gjatë kësaj periudhe kohore **110 (104 + 6)** procedime penale nga 120 (82 + 38) te vitit 2016 ose **12** ceshtje me pak se ne vitin 2016 (shifrat 6 dhe 38 sipas viteve jane ceshtje te pushuara per efekt te parashkrimit). Nga keto :

- ✚ **10** procedime jane pushuar për mungesë të faktit penal dhe të elementëve të veprës penale.
- ✚ **4** procedime për mungesë të provave të mjaftueshme.
- ✚ **90** procedime për shkaqe të tjera procedurale.

Është pushuar ndjekja penale për **53** persona (në këtë numër përfshihen si të pandehurit ashtu edhe personat ndaj të cilëve janë kryer hetime duke qenë se statusi procedural i tyre është i njëjtë).

Numri i çështjeve të pushuara me të pandehur është **4**, nga të cilët një person ka qenë me masë sigurimi "Arrest Burg".

Numri i çështjeve të pushuara me persona nën hetim është **49**, nga të cilët dy raste për mungesë fakti, **4** raste për mungesë të provave dhe **43** raste për shkaqe të tjera.

Çështjet e pushuara zënë rreth **17.7%** të numrit të përgjithshëm të çështjeve të përfunduara në periudhën 1 vjeçare (në këtë llogaritje nuk përfshihen çështjet e transferuara dhe ceshtjet e pushuara per shkak te parashkrimit).

Numri më i madh i çështjeve të pushuara sic shihet është "*për shkaqe të tjera procedurale*", gjithsej 90 çështje ndër të cilat vendin kryesor e zënë ato që kanë të bëjnë me heqjen dorë nga ankimi prej të dëmtuarve për ato procedime ku ndjekja penale është e kushtëzuar nga vullneti i tij. Gjate ketij viti jane pushuar per efekt te afateve te parashkrimit edhe **6** ceshtje penale.

Çështjet e pushuara për mungesë të provave, gjithsej **4** çështje, zënë **3%** të numrit të çështjeve të pushuara dhe vetem ne nje rast behet fjale per person te arrestuar. Gjithsesi kjo situatë nevojitet te korigjohet mbasi tregon se ne keto raste nuk jane bere perpjekjet e duhura për të provuar akuzat në ngarkim të personave ndaj të cilëve ushtrohet ndjekje penale. Kjo natyrisht kerkon dhe analiza te detajuara me prokurorët e çështjeve me qëllim që vendimet e marra të jenë në përputhje të plotë me ligjin dhe provat e administruara.

Duke analizuar procedimet e pushuara për mungesë të faktit dhe të elementëve të veprës penale, gjithsej **10** çështje, që për këtë vit rezultojnë të zënë **9.6 %** të çështjeve të pushuara, konstatohet se pergjithesisht eshte bere kujdes per verifikimin paraprak te materialeve kallezuese dhe një vlerësim i drejtë i fakteve të paraqitura në keto materiale.

Në vitin 2017 jane ankimuar ne gjykate **12** vendime pushimi. Eshte pranuar ankimi ne te **3** raste. Ne **4** raste Gjykata ka lene ne fuqi vendimin e pushimit. Rastet e tjera jane ne gjykim. Ne numerin e pergjithshem te pushimeve jane te perfshira edhe rastet e kerkesave per pushim ne gjykate (mbas dt. 01.08.2017) gjithesej 28 kerkesa nga te cilat per 5 ceshtje eshte pranuar kerkesa, ne nje rast eshte vendosur kthimi akteve dhe te tjerat jane ne proces gjykimi.

PROCEDIMET PENALE TE PEZULLUARA

Gjatë vitit 2017 janë pezulluar 227 procedime penale ose 37% e çështjeve të përfunduara , krahasuar kjo me vitin 2016 ku numri i ceshtjeve te pezulluara ka qene 432 ose 55 % e ceshtjeve te perfunduara shihet qarte se numri i ketyre çështjeve kete vit është zvogeluar ndjeshem. Numrin më të madh të procedimeve penale të pezulluara e zënë procedimet për veprën penale të “Vjedhjes” (neni 134 i K.Penal) dhe te kultivimit te bimeve narkotike kjo per shkak te kultivimit te ketyre bimeve ne toka pa pronar por edhe per pune te pamjaftueshme nga strukturat e shtetit per identifikimin e parcelave ku kultivohen keto bime , perfshi ketu policine dhe organet e pushtetit vendor. Gjithesesi kete vit konstatojme se nje nga faktoret qe ka ndikuar ne kete ulje te ndjeshme eshte numeri shume me i vogel se vitin e kaluar i ceshtjeve penale per veprën penale “Kultivimi i bimeve narkotike “ (nga 188 ne 55 procedime) cka tregon se ka pasur nje mobilizim me te madh nga organet ligjzbatuese per kontrollin e territorit dhe parandalimin ne kohe te perhapjes se kesaj vepre penale.

PROCEDIMET E DËRGUARA PËR GJYKIM

Në vitin 2017 janë dërguar për gjykim 250 procedime penale ose 12 procedime më pak se vitin e kaluar, me 272 të pandehur nga të cilët 79 të arrestuar dhe pjesa tjetër të ndjekur me masa të tjera sigurimi. Procedimet penale të dërguara për gjykim zënë rreth 41% të numrit të përgjithshëm të procedimeve penale të përfunduara (llogaritja është bërë duke marrë në konsideratë të gjitha çështjet e përfunduara: dërguar gjyqit+të pushuara+të pezulluara). Pra, rezulton se ky tregues per kete vit ka ardhur ne rritje ne nje masae prej + 6.5 % kjo fale perpjekjeve me te medha te prokuroreve dhe oficerëve te policise gjyqesore per te siguruar provat e nevojshme dhe derguar perpara Gjykates autoret e veprave penale.

Sqarojme se ne kete shifer perfshihen 95 kerkesa per dergimin e ceshtjes ne gjyq mbas hyrjes ne fuqi te K.Pr.Penale (nje gusht 2017) nga te cilat ne 47 raste kerkesat jane pranuar nga gjykata, ne nje rast eshte vendosur pushimi ceshtjes dhe te tjerat jane ne proces gjykimi ne seance paraprake. Eshte aplikuar urdheri penal veten ne nje rast.

Gjatë vitit 2017 vlen te permenden si procedime te derguara per gjykim:

- ✚ procedimi penal në ngarkim të të pandehurit R.D per vrasje te mbetur ne tentative , parashikuar nga neni 76,22 te K.Penal , procedim i hetuar nga prokurori **Florian Bonjaku**

- ✚ procedimi penal në ngarkim të të pandehurve E.D, V.S, R.D ,akuzuar per kryerjen e vepres penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armeve, armeve shperthyese dhe municionit” parashikuar nga neni 278/6-25 te K.Penal, procedim i hetuar nga prokurori **Bujar Memia**
- ✚ Procedimi penal në ngarkim të të pandehurve E.D. E.T, S.V për kryerjen e vepres penale “Shkaterrimi i pronës me eksploziv” sipas neneve 152, 278/1 te K.Penal hetuar nga prokurori **Bujar Çici** ne te cilin jane perdorur me sukses metodat proaktive te hetimit.

Duke vlerësuar me seriozitet shqetësimet e ngritura nga qytetarët nëpërmjet kallëzimeve të depozituara prej tyre në prokurori për cenimin e interesave të ligjshme të tyre nga veprimtaria në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës nga nëpunësit shtetërorë, si dhe nga përdorimi i dokumenteve të falsifikuara, kryesisht në përvetësimin e paligjshëm të pronave, por edhe për në abuzimet dhe përfitimet nga lejet e padrejta të ndërtimit. Gjate këtij viti janë regjistruar disa procedime për veprat penale të shpërdorimit të detyrës dhe të falsifikimit të dokumentave, nga te cilat duhet vecuar ceshtja penale ne ngarkim te F.SH dhe M.R ish funksionare te organeve te pushtetit vendor te akuzuar per “Shpërdorim të detyrës” dhe “Falsifikim të dokumenteve “ sipas neneve 248, 186 te K.Penal, ceshtje e hetuar nga prokurorja **Mirela Kapo**.

Po kështu janë dërguar për gjykim edhe mjaft procedime për veprat penale “Kultivimi i bimeve narkotike”, “Prodhimi dhe shitja e narkotikeve”, “Vjedhje”, “Mashttrim”, “Ndertim i paligjshem etj.

Nga procedimet e dërguara për gjykim pjesën kryesore e zënë procedimet e regjistruara mbi bazën e materialeve të referuara nga Organet e Policisë së Shtetit dhe nga qytetarët dhe dy procedime janë filluar kryesisht mbi bazen e materialeve të bera publike nga media e shkruar dhe vizive.

Në TOTAL në vitin 2017 :

Janë përfunduar 606 procedime me **363 (296+67)** persona të pandehur/ nën hetim nga të cilët **94** të arrestuar (ketu perfshihen edhe 6 procedimet e pushuara per efekt te parashkrimit te vepres penale).

Kanë mbetur në hetim **182(179+3)** procedime penale me **24** të pandehur dhe **114** persona nën hetim, dhe **50** të arrestuar. Kete vit rezulton te jene mbartur **51** procedime me shume se vitin e kaluar dhe kjo gje lidhet me mungesat ne organike te prokuroreve (dy me pak se organika e miratuar).

Objektivi ynë për çështjet e mbartura është që të përfundojnë brenda tremujorit të parë të vitit 2018.

Është me vend të përmendim se gjatë këtij viti janë konstatuar edhe zgjatje të panevojshme të afatit të hetimit për procedime të caktuara për shkaqe subjektive, pra, për moskryerje të detyrave nga oficerët e policisë gjyqësore dhe mungesë kontrolli nga prokurorët e çështjeve. Fakti që janë zgjatur afatet e hetimeve **mbi tre muaj** për **77** procedime

nga 52 ne vitin 2016), me **83** të pandehur ose persona nën hetim tregojnë se është kërkuar më shumë vëmendje, më shumë kontroll nga prokurorët e çështjeve, por edhe nga drejtuesi i prokurorisë për të eliminuar zvarritjet dhe për të zgjidhur çështjet brenda afatave procedurale.

Treguesit e punës për secilin prej prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore janë si më poshtë:

Prokurori	Procedime penale të përfunduara	Dërguar në gjyq	Pushuar	Pezulluar	Shpallur moskompetenca	Mosfillime	Mbartur
Petrit Çano	16	5	8	3	0	3	1
Bujar Çiçi	92	43	14	33	2	53	4
Bujar Memia	146	70	30	43	3	65	62
Florian Bonjaku	151	57	21	67	6	75	69
Mirela Kapo	167	71	29	59	8	77	46
Sulejman Tola	34	4	8	22	-	-	-
Totali	606	250	110	227	19	273	182

Eshtë për tu theksuar se prokurorët **Bujar Çiçi** dhe **Florian Bonjaku** në periudha të ndryshme kanë qenë të ngarkuar edhe me ekzekutimin e vendimeve penale detyrë të cilën e kanë kryer me korrektesë.

Oficeri i Policisë Gjyqësore Arjan Resnja:

Ka përfunduar gjithsej **83** procedime, nga të cilat:

8 janë referuar për pushim procedimi.

63 janë referuar për dërgimin e procedimit në gjyq.

12 është referuar për pezullimin e gjykimit.

19 procedim mbeten në hetim.

Oficeri i Policisë Gjyqësore Rexhep Derveni:

Ka përfunduar gjithsej **129** procedime, nga të cilat:

17 janë referuar për pushim procedimi.

62 janë referuar për dërgimin e procedimit në gjyq .

13 janë referuar për pezullim.

32 janë referuar për mosfillim procedimi.

5 janë referuar për transferim.

22 procedime mbeten në hetim.

Oficeri i Policisë Gjyqësore Anila Dusha:

Ka përfunduar gjithsej **80** procedime, nga të cilat:

18 janë referuar për pushim procedimi.
54 janë referuar për dërgimin e procedimit në gjyq.
8 janë referuar për pezullim.
10 procedime mbeten në hetim
Oficeri i Policisë Gjyqësore Renato Tushaj:
Ka përfunduar gjithsej 42 procedime, nga të cilat:
13 janë referuar për dërgimin e procedimit në gjyq.
9 janë referuar për pezullim.
7 janë referuar për pushim procedimi.
13 janë referuar për mosfillim procedimi.
25 procedime mbeten në hetim

GJYKIMI

Për vitin 2017 ka përfunduar gjykimi për **212** procedime me **237** të pandehur nga të cilët **64** të arrestuar. Kanë mbetur të mbartura në gjykim **68** procedime penale.

Nga këto 2 procedime janë gjykuar me gjykim të drejtpërdrejtë ose **0.9%** te ceshtjeve te derguara per gjykim. Ne krahasim me vitin 2016 kemi nje ulje te ndjeshme te ketij treguesi (15 % ne vitin 2016)

Për 220 procedime është zhvilluar gjykim i shkurtuar.



Për 45 procedime është zhvilluar gjykim i zakonshëm, nga te cilet **2** jane gjykuar ne mungese.

Nga prokurori është kërkuar dënimi me burgim për **99** të pandehur dhe nga Gjykata është caktuar dënimi me burgim për **95** të pandehur.

Për 44 të pandehur prokurori ka kërkuar dënimin me gjobë dhe nga gjykata janë dhënë dënime me gjobë për **43** të pandehur.

Ndërsa nga 72 kërkesa të prokurorit për pezullim të egzekutimit të vendimit Gjykata ka dhënë këtë lloj dënimi për **75** te tilla.

Më poshtë paraqiten grafikisht llojet e dënimeve të kërkuara nga prokurorët dhe mënyra se si ka vendosur gjykata.



Për vitin 2017 eshte dhene nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kruje dy pafajesi e te plota ose 0.9% të çështjeve të gjykuara. Në njërin nga rastet i pandehuri F.D , pa mase sigurimi dhe behet fjale per vepren penale “Shperdorim detyre”, për të cilën prokurori çështjes Bujar

Memia ka bërë ankim. Rasti tjetër i pandehuri I.S ka qenë me masë sigurimi “arrest në burg” në mungesë dhe bëhet fjalë për veprën penale të “Kultivimit të bimeve narkotike”.

Gjykata ka vendosur pushimin e procedimit gjatë gjykimit për 26 **ceshtje**.

Prokurori ka kërkuar dhe gjykata ka vendosur në **2** raste kthimin e akteve. Te dy keto procedime jane ende ne hetim.

Për fazën e gjykimit i është kushtuar rëndësi sigurimit të provave të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e të pandehurve si dhe diferencimit të llojit dhe masës së dënimit në varësi të veprës penale të kryer.

Për veprat penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, si ato kundër jetës dhe shëndetit, vjedhjet, mashtrimet, marrëdhëniet seksuale me dhunë, shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor, veprat penale në fushën e narkotikëve, etj. kërkesat tona për llojin dhe masën e dënimit kanë qenë të tilla që t’i shërbejnë parandalimit dhe ndëshkimit të këtyre veprave penale. Kjo reflektohet në faktin se gjatë vitit 2017 në rrethin tonë kane ardhur ne ulje veprat penale kunder rendit dhe sigurise publike, veprat penale kunder mjedisit dhe kunder autoritetit te shtetit por eshte konstatuar rritje e veprave penale ne fushen e pasurise dhe sferes ekonomike, veprat penale kunder jetes dhe shendetit si dhe veprat penale kunder drejtesise. Gjithesesi, duke analizuar gjithë treguesit e këtij viti mendoj se është e nevojshme që politika e dënimit të përmirësohet në vijimësi duke e bërë më fleksibël dhe duke e përshtatur me format dhe tendencat e kriminalitetit në rrethin tonë.

Gjatë vitit 2017 ne Gjykatën Administrative te Apelit ka perfunduar gjykimi per dy **kerkesa** për kompensim për burgim të padrejtë dhe jane ne gjykim edhe 3 (tre) raste te tjera.

Gjatë vitit 2017 kanë qenë **12** rastet kur prokurorët kanë apeluar vendimin e Gjykatës: në 3 raste kundër vendimeve të pushimit dhe pafajesise te ceshtjes dhe 10 raste per lloj dhe mase denimi.

Nga rastet e ankimuara ne dy raste ankimi eshte pranuar dhe rastet e tjera jane ne gjykim.

Është ushtruar e drejta e ankimit edhe kundër vendimeve për masat e sigurimit në **3** raste, dy raste nga te cilet nuk jane pranuar nga Gjykata e Apelit.

EGZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kruje gjatë kësaj periudhe kohore ka kryer edhe detyrimet procedurale në fushën e egzekutimit të vendimeve penale. Prokurori **Bujar Çiçi + Florian Bonjaku** te ngarkuar me këtë detyrë ka urdhëruar egzekutimin e **161** vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Prej tyre:

Janë nxjerrë 78 urdhëra për egzekutimin e vendimeve me burgim nga te cilet jane egzekutuar 76 urdhëra.

Janë nxjerrë 15 urdhëra për egzekutimin e vendimeve me gjobë nga te cilet jane egzekutuar vetem 3 urdhëra.

Janë nxjerrë 68 urdhëra për dënimet alternative të cilët rezultojnë të jenë egzekutuar 55 urdhëra.

Janë nxjerrë 83 urdhëra për egzekutimin e vendimeve të Gjykatave për shpenzimet procedurale nga të cilat janë egzekutuar **22**, **12** urdhëra janë pezulluar, të tjerat janë pa egzekutuar.

Gjithashtu janë kryer edhe detyrimet e tjera që lidhen me ankimet e palëve në Gjykatë gjatë fazës së egzekutimeve. Problem mbetet ende egzekutimi i dënimeve me gjobë, kjo kryesisht për shkak objektiv (pamundësinë e pagimit të tyre nga personat e dënuar), por në ndonjë rast edhe për moskryerje të detyrës nga organet përmbarimore.

Po kështu gjatë këtij viti janë shqyrtuar edhe **132** kërkesa të të denuarve për lirim parakohe me kusht, qëndrim në shtëpi, lirim për shkak sëmundje etj nga të cilat janë pranuar **6** kërkesa, janë rrefuzuar dhe pushuar **30** nderkohe që për të tjerat vazhdon gjykimi.

Janë egzekutuar **4** leterporosi nga jashtë shtetit, janë realizuar **2** ekstradime nga jashtë shtetit dhe **1** për jashtë shtetit si dhe është bërë njohja e **1** vendimi penal të gjykatave të huaja.

Janë nxjerrë **6** urdhëra për kerkim nderkombëtar dhe janë hequr nga kerkimi 5 persona.

VEPRIMTARIA ADMINISTRATIVE

Gjatë vitit 2017 në veprimtarinë administrative të organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë janë reflektuar ndryshimet e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë” dhe ligjeve të tjera në kuadër të Reformës në Drejtësi.

Në këtë kuadër është miratuar Regullorja “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë Krujë” në të cilën janë përcaktuar në mënyrë specifike detyrat e çdo punonjësi të administratës. Me urdhëra të brendshme të nxjerra nga Drejtuesi i Prokurorisë mbi bazën e udhëzimeve të dërguara nga Prokurori i Përgjithshëm është normuar puna për administrimin e regjistrave, për shpërndarjen e çështjeve fillimisht me short manual dhe pastaj me elektronik., për organizimin dhe koordinimin e punës në prokurori duke pasur parasysh këtë rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet drejtuesit të Prokurorisë, prokurorëve dhe gjithë pjesës tjetër të personelit në përputhje me ndryshimet e reja të Ligjit për Prokurorinë dhe K.Pr.Penale etj.

Po kështu ka vijuar puna për kryerjen e detyrave në përputhje me ligjin organik dhe Udhëzimin e Përbashkët të Prokurorit të Përgjithshëm me Ministrin e Brendshëm për funksionimin e Policisë Gjyqësore. Nga përvoja e deritanishme rezulton se me gjithë përmirësimet ka akoma pengesa në mirëfunksionimin e këtij organi. Kjo lidhet me transferimet e shpeshta të oficerëve të policisë gjyqësore që ka ndikuar në cilësinë dhe shpejtësinë e hetimeve si dhe vonësia të akteve të ekspertimit të cilat kanë sjellë zvarritje të hetimeve. Gjithsesi referuar vitit të kaluar situata këtë vit ka qenë më e përmirësuar dhe falë kontakteve të ngushta që janë vendosur mes drejtuesve të dy organeve shpresojmë që këto mangësi të minimizohen.

Kete vit eshte realizuar nje bashkëpunim më i mirë me Zyrat Rajonale të Drejtorisë së Policisë Durrës vecanerisht ne Zyren Kunder Narkotikeve dhe rezultatet e arritura kane qene shume me te mira nderkohe qe nuk eshte punuar me te njejtin ritem nga Zyra kunder krimin ekonomik dhe kjo ka sjelle si pasoje zvarritjen e hetimeve per disa raste per pastrim parash.

Gjatë vitit 2017 eshte treguar kujdes per te trajtuar me seriozitet shqetësimet e ngritura nga palët në proces apo qytetarët është kërkuar në vazhdimësi që prokurorët të jenë korrekt me qytetarët, me vartësit, me kolegët, të ruajnë një figurë të pastër etiko-morale duke i shërbyer në radhë të parë vetes, por edhe ruajtjes së një imazhi të pastër të Institucionit. Gjate ketij viti nuk rezulton qe ndaj prokuroreve apo oficerëve te policise gjyqesore te jete marre ndonje mase disiplinore apo perfshirje te tyre ne veprimtari te paligjshme.

Është me vend të theksojmë edhe përkushtimin e treguar nga personeli administrativ i kësaj prokurorie, kryesekretari, sekretaret ,punonjesja e pastrimit dhe shoferi, puna e të cilëve ka qenë mbështetje e rëndësishme për prokurorët dhe oficerët e Policisë Gjyqësore në ushtrim të detyrës së tyre, por edhe për qytetarët të cilëve u janë ofruar shërbime administrative të cilësisë së lartë. Jane shlyer te gjitha detyrimet financiare per vitin 2017. Për të gjitha rastet e gadishmërisë dhe mbikohës së punës të cilat janë evidentuar në menyrë të plotë punonjësit e kësaj Prokurorie janë paguar.

Vlen te theksohet se kete ngarkese pune Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Kruje mbas daljes ne pension ne fillim te muajit shkurt te prokurorit Sulejman Tola dhe komandimit ne nje rreth tjeter per disa muaj te prokurorit Bujar Çiçi e ka perballuar me nje mungese organike prej dy prokuroresh. Mendojme se organika e miratuar per kete prokurori pese prokurore + drejtuesin, nese do te jete e plotesuar eshte e mjaftueshme per te perballuar ngarkesen dhe per te kryer nje pune me cilesore duke pasur parasysh numerin e ceshtjeve penale qe trajtohen gjate nje viti por edhe faktin qe ne teritorin e ketij rrethi gjyqesor funksionojne edhe dy institucione te vuajtjes se denimit me rreth 700-800 te denuar kerkesat e te cileve ne Gjykate nga viti ne vit kane ardhur duke u rritur.

Nga analiza në tërësi e elementëve që u përmendën më lart, për të ardhmen prioritetet tona kryesore do të jenë:

1. Implementimi me sukses i gjithë ndryshimeve ne K.Penal dhe K.Pr.Penale duke duke i dhene perparesi pavaresise se prokuroreve ne vendimmarrje por edhe aplikimit te instituteve te reja te parashikuara ne keto Kode.
2. Përfundimi brenda tremujorit të parë të vitit **2018** të të gjitha çështjeve të mbartura nga viti **2017**.
3. Vazhdimi i ndjekjes me përparësi të procedimeve penale ne fushen e kultivimit te bimeve narkotike me objektiv goditjen e tyre ne kohe cka do te sjelle minimizimin e ketij fenomeni , kundër pasurisë, si vjedhjet e banesave, lokaleve, automjeteve, mashtrimet, veprat penale në fushën e krimin ekonomik dhe korrupsionit, abuzimit me detyrën të nëpunësve shtetërorë, veprat penale kunder jetës, shëndetit, veprat penale kunder femijeve, martesës dhe familjes me objekt te vecante veprat penale kunder dhunes ne

familje , veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, në veçanti shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor dhe çdo lloj forme tjetër të krimit që konsiderohet shqetësuese për komunitetin ku ushtrojmë detyrën.

4. Ndjekja në vazhdimësi e çështjeve për ngjarje kriminale të rënda të pezulluara në vitet e mëparshme, në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet policore me qëllim për të mos lejuar askënd t'i shpetojë ndëshkimit ligjor për veprat e kryera.
5. Rritja e funksionit drejtues dhe kontrollues të prokurorit në hetimet paraprake të kryera nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore.
6. Standartizimi i praktikave për zgjidhjen perfundimtare të çështjeve penale, masave të sigurimit dhe atyre të denimit duke u bazuar mbi praktikën e mëparshme dhe duke pasur si qëllim një trajtim të drejtë dhe të barabartë të shtetasve.
7. Përmirësimi i organizimit, drejtimit dhe kontrollit brenda organit të Prokurorisë në përputhje me Ligjin nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe “Rregullores Standarte të Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë të Juridiksionit të Përgjithshëm” për tu përshatur me ndryshimet e këtij ligji me synimin për t’ju përgjigjur në kohë dhe me cilësi të kërkesave të luftës kundër kriminalitetit, forcimit të disiplinës së brendshme dhe të vullnetit për të identifikuar çdo lloj problematike brenda organit dhe për ta goditur atë përpara se të ndodhë.
8. Respektimi i detyrimeve të ligjit procedural penal, rekomandimeve të Këshillit të Ministrave për luftën kundër kriminalitetit dhe Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm në këtë drejtim.
9. Rritja e profesionalizmit të prokurorëve dhe ruajtja e një figure morale të pastër jashtë çdo ndikimi për të përfaqësuar në mënyrë dinjitoze Institucionin në raport me publikun, brenda dhe jashtë orarit të punës.

**DREJTUESI I PROKURORISË
PETRIT ÇANO**